



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KD. Nr.11-3/2022

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga Agron Curri - Kryetar, Rrahim Ajeti dhe Bajram Lajçi – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në zyrën Disiplinore të OAK-së, në çështjen disiplinore sipas propozimit 17-3/2021 të dt. 21.04.2022, të Prokurorit Disiplinor të OAK-së Rexhep Veseli, kundër avokatit _____ me adresë në rr. _____,

në bazë të nenit 51 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, të Ligjit për Avokatinë, nr. 04/L-193, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15 të Statutit të OAK-së dhe nenit 36 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, pas mbajtjes së seancës jopublike të shqyrtimit kryesor disiplinor, me dt. 06.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I paraqituri, avokat _____ nga _____ me adresë në rr. _____, me nr. _____ të licencës _____ të OAK-së.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

I paraqituri av. _____ me datë 03.03.2021 i është çasur objektit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, veprim ky në kundërshtim me vendimin e Këshillit Drejtues të OAK-së nr.284/21 të datës 03.02.2021.

Me çka, ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.15 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 36 paragrafi 1 pika a. të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Andaj,

Kolegji Disiplinor i OAK-së, në paitim me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Avokatinë, të paraqiturit, avokatit _____ i shqipton masën disiplinore:

V Ë R E J T J E

I. Obligohet i paraqituri av. _____ që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) Euro.

III. Pagesa e paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Prokurori Disiplinor i OAK-së, në Komisionin Disiplinor ka paraqitur propozimin disiplinor nr. 17-3/2021 dt. 21.04.2022, kundër të paraqiturit, av. _____ nga _____, me adresë në rr. _____ me nr. të licencës _____ të OAK-së, me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore për shkak se i paraqituri me datë 03.03.2021 i është çasur objektit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, veprim ky në kundërshtim me vendimin e Këshillit Drejtues të OAK-së nr.284/21 të datës 03.02.2021. Propozimi është bërë sipas procedurës së nisur sipas detyrës zyrtare,

Kolegji Disiplinor, me dt. 16.05.2022, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi shqyrtoi propozimin e Prokurorit Disiplinor me provat e bashkëngjitura, konstatoi se ekziston arsyeja bazuar për vazhdimin e procedurës disiplinore ndaj avokatit _____ nga _____

Kolegji Disiplinor, mbajti seancën e shqyrtimit kryesor më datën 06.06.2022 në prezencën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, z. Rexhep Veseli, dhe të paraqiturit av. _____

Kolegji Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 29, 30,31, 33 dhe 34 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore dhe deklarin të të paraqiturit dhe të Prokurorit Disiplinor të OAK-së se nuk kishte vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit të Prokurorit Disiplinor me nr. 17-3/2021 dt. 21.04.2022. Prokurori Disiplinor, z. Rexhep Veseli lexoi propozimin disiplinor duke mbetur edhe me tej pranë propozimit.

I paraqituri u njoftua me të drejtat e tij konform dispozitave të nenit 26 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së dhe lidhur me këtë dhe pranimin e përgjegjësisë disiplinore, i njëjti deklaroi se i ka kuptuar të drejtat e tij, e kupton propozimin e Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe se e **pranon** përgjegjësinë disiplinore që i vihet në barrë sipas Propozimit Disiplinor.

Kolegji e pranoi pranimin e përgjegjësisë disiplinore nga i paraqituri dhe mbështetur në nenin 27 paragrafi 3, i Rregullores Disiplinore, vendosi që të vazhdohet me fjalën përfundimtare, pa qenë nevoja e zhvillimit të procedurës së provave dhe administrimit të tyre.

Prokurori Disiplinor në fjalën përfundimtare deklaroi: Pas pranimin të përgjegjësisë nga av. _____ ZPD kërkon që kjo shkelje të trajtohet si shkelje e rëndë, por si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së shqiptimit të masës propozon që Komisioni ta ketë paraqyssh pranimin e fajësisë nga avokati, pendimin e shprehur në përgjigjen e datës 05.03.2021 nga avokati dhe të kaluarën e pastër disiplinore.

I paraqituri av. _____ në fjalën përfundimtare deklaroi: Unë edhe para Prokurorit Disiplinor të OAK-së kam shprehur keqardhje lidhur me veprimin që kam bërë, nuk e kam bërë

me qëllim shkeljen e vendimit por ka qenë fillimi im në ushtrimin e profesionit të avokatit, nuk e kam ditë që është shkelje çasja në objektin e prokurorisë dhe dorëzimi i një fature për angazhim ex-officio tek zyra e financave të Prokurorisë. Gjatë muajit janar të atij viti kam qenë i infektuar me Covid – 19 edhe kam pasur shumë rëndë gjendjen shëndetsore, nuk kam pasur mundësi që ti përcjell emailat që i kam pranuar nga OAK. Me datën 05.02.2021 kam pranuar një thirrje telefonike nga OAK që të paraqitem në stacionin policor të jugut në Prishtinë, në intervistimin e një të mituri dhe unë si avokat i ri ju kam përgjigjur thirrjes së OAK-së me qëllim që ta ofoj shërbimin tim profesional, kjo ka qenë fatura e dytë që e kam dorëzuar për shërbimet ex-officio, duke e pasur në dije se faturat në Prokurori dorëzohen nga data 1 deri në 5 të muajit vijues dhe për shkak të kësaj kam menduar se në qoftë se nuk e dorëzoj brenda kesaj kohe do më humb e drejta në kompensim. Asnjëherë nuk kam pasur dhe as nuk kam për qëllim që ti shkeli vendimet e OAK-së, vendimet e OAK-së i respektoj me përpikmëri, mirëpo nuk e kam ditur se është shkelje çasja në objektin e PTH, respektivisht në zyrën e financave paraqet shkelje të vendimit të OAK-së. Andaj kërkoj edhe nga ju si Komision Disiplinor që të mi mirëkuptoni të gjitha arsyet e cekura më lartë dhe gjendjen e rëndë financiare të cilën po e kalojmë ne si avokatë pas pandemisë covid – 19. Edhe njëherë kërkoj falje dhe mirëkuptim nga ju Komision i respektuar, e kam thënë gjendjen reale se çka ka ndodhur dhe kam rënë në lajthim juridik, dhe diqka tjetër nuk kam për të shtuar.

Kolegji Disiplinor, pas pranimit të përgjegjësisë, shqyrtimit dhe vlerësimit në tërësi të rrethanave të rastit, propozimit të Prokurorit Disiplinor dhe provave të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, fjalëve përfundimtare të palëve në procedurë, me shumicë votash erdhi në përfundim se veprimi av. [emri i avokatit], i datës 03.03.2021 kur i është çasur objektit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në kundërshtim me vendimin e Këshillit Drejtues të OAK-së nr.284/21, paraqet shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.15 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 36 paragrafi 1 pika a. të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, dhe se avokati [emri i avokatit] është përgjegjës për këtë shkelje.

Kolegji vlerësoi se veprimi i të paraqiturit në kundërshtim me vendimet e Këshillit Drejtues paraqet shkelje të rëndë disiplinore dhe se me veprime të tilla shkelet autoriteti i OAK-së në raport me vet anëtarësinë e saj por edhe në raport me institucionet tjera, e në rastin konkret në raport me Prokurorinë Themelore në Prishtinë (PTHP) ndaj të cilës ishte marr vendimi për bojkotim. Kolegji Disiplinor vlerësoi se dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të KD të OAK-së nr. 284/2021 i dt. 03.02.2021 për bojkotimin e PTHP është mjaftë i qartë. Në dispozitivin e vendimit precizohet qartë se deri të vendimi për bojkotim kishte ardhur pikërisht për shkak të trajtimit të pa dinjitetshëm të avokatve lidhur me çasjen e avokatve në objektin e PTHP, ndërsa në arsyetimin e vendimit janë specifikuar veç e veç të gjitha pengesat me të cilat ballafaqohen avokatët me rastin e çasjes së tyre në Objektin e PTHP, e të cilat pengesa është kërkuar të hiqen/eliminohen. Andaj, pretendimin e të paraqiturit dhënë në fjalën përfundimtare se ai nuk e ka ditur se vendimi i KD të OAK-së ka nënkuptuar edhe çasjen në objektin e PTHP, Kolegji e vlerësoi si të pa bazuar. Për me tepër, aktet normative të OAK, ku bënë pjesë edhe vendimi i KD nr.284/2021, duhet të jenë pjesë përbërëse e vetëdijes dhe bindjes së secilit avokat dhe se mosnjohja apo dilemat e avokatve lidhur me këto akte apo permbajtjen e tyre nuk e arsyeton avokatin për çfarëdo shkelje të dispozitave të tyre.

Kolegji të paraqiturit i shqiptoi masën vërejtje të paraparë me nenin 51 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Avokatinë, dhe atë, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe dhe veçanërisht lehtësuese. Pranimin e përgjegjësisë, Kolegji e vlerësoi si rrethanë veçanërisht lehtësuese, si

rrethana tjera lehtësuese Kolegji i vlerësoi: pendimin e sinqertë të të paraqiturit për shkeljen disiplinore, të kaluarën disiplinore, ku sipas shënimeve të Odës, nuk ishte zhvilluar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër disiplinore kundër tij, parasysh kolegji e pati edhe kërkimfaljen dhe respektin e madh që i paraqituri shfaqti për Odën dhe autoritetin e saj (si në përgjigje me shkrim edhe në sëancën e shqyrtimit kryesor), situatën e pandemisë Covid – 19, por edhe propozimin e Prokurorit Disiplinor në fjalën e tij përfundimtare që, me rastin e përcaktimit të llojit dhe masës disiplinore të vlerësohen rrethanat lehtësuese.

Kolegji vendosi për këtë lloj të masës, me bindjen se është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore, e me të cilën synohet ruajtja e autoritetit dhe prestigjit të avokatisë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin, sepse shpenzime për ekspert, dëshmitarë dhe përkthyes nuk kishte. Vendimi për paushallin, u mor në bazë të nenit 37 paragrafi 1, të Rregullorës për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

Andaj, nga se u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. Nr.11-3/2022, dt. 06.06.2022

Procesmbajtësja

Ma.sc.Vjollca Ajeti

Kryetar i Kolegjit Disiplinor

Av. Agron Curri

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.